



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 7 nëntor 2019
Nr. ref.: RK 1465/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI110/19

Parashtrues

Fisnik Baftijari

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të
Kosovës, Pml. nr. 123/2019, të 14 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Fisnik Baftijari, me vendbanim në komunën e Gjakovës, të cilin e përfaqëson Sokol Dobruna, avokat nga Gjakova (në tekstin e mëtejshëm: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktgjykimin [Pml. nr. 123/2019] e 14 majit 2019 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së aktgjyimit të kontestuar përmes së cilit, sipas pretendimit të parashtruesit të kërkesës, janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 24 [Barazia para Ligjit], 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] të Kushtetutës të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), si dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 28 qershor 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën përmes postës në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 2 korrik 2019, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë përmes postës dokumente shtesë.
7. Më 3 korrik 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Bekim Sejdiu (kryesues), Remzije Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi (anëtarë).
8. Më 16 korrik 2019, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 16 korrik 2019, Gjykata njoftoi Gjykatën Supreme për kontestimin e Aktgjyimit [Pml. nr. 123/2019] të 14 majit 2019 dhe të njëjtës i ofroi një kopje të kërkesës.
10. Më 25 korrik 2019, Gjykata kërkoi nga parashtruesi i kërkesës plotësimin e formularit zyrtar të Gjykatës për parashtrimin e kërkesës në Gjykatë, në mënyrë që të sqarohen ankesat sipas Kushtetutës.
11. Më 13 gusht 2019, parashtruesi dorëzoi në Gjykatë përmes postës formularin e plotësuar.
12. Më 8 tetor 2019, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 28 shtator 2015, Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur Aktakuzën [PP. nr. 1288/2015] kundër parashtruesit të kërkesës në cilësi të të akuzuarit, për shkak të veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332, par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPRK) me propozimin që i njëjti të shpallet fajtor, të dënohet sipas Ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.
14. Më 27 tetor 2016, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktgjykimit [P. nr. 621/15] e shpall fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale uzurpim i pronës së paluajtshme nga neni 332.1 i KPRK-së dhe i shqipton dënim me kusht në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohej nëse i akuzuari (parashtruesi i kërkesës) brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Gjithashtu ai detyrohet që në afat prej 3 (tre) muaj, të lironte pronën e paluajtshme të uzurpuar, përkatësisht banesën, të paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të paushallit gjyqësor, ndërsa pala e dëmtuar M. B., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike ishte udhëzuar në kontest civil.
15. Më 21 mars 2017, Gjykata e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit), përmes Aktgjykimit [PA. 1. nr. 1505/2016] e ka refuzuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, ndërsa e vërtetoi Aktgjykimin e shkallës së parë.
16. Kundër këtyre aktgjykimeve, i dënuari ka paraqitur dy kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve tjera që kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor si dhe shkeljes së ligjit penal, me propozim që aktgjykimet e kundërshtuara të anulohen dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ose të ndryshohet, ashtu që i njëjti të lirohet nga akuza.
17. Më 16 maj 2017, Prokurori i Shtetit të Kosovës, me parashtresën [KMLP. II. nr. 73/2017], propozoi që të refuzohet si e pabazuar kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë.
18. Më 22 gusht 2017, Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 109/17] ka miratuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, me ç'rast është anuluar Aktgjykimi i Gjykatës Themelore [P. nr. 621/15] dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Apelit [PA. 1. nr. 1505/16] dhe lënda i është kthyer gjykatës së shkallës së parë në rivendosje. Gjykata Supreme, ndër arsytet e miratimit të kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë përmend "*[... që Aktgjykimi i shkallës së parë është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale për faktin se aktgjykimi i përmendur nuk përmban arsye për faktet vendimtare të cilat kanë të bëjnë me atë nëse pranimi i fajësisë nga i dënuari gjen mbështetje në provat me të cilat ka disponuar gjykata]*". Gjithashtu, Gjykata Supreme thekson që Gjykata Themelore duhej të jepte "*[... arsye lidhur me vetë aktin e deklarimit të dënuarit për fajësinë, respektivisht*

të jep arsye se në çfarë provash bazon bindjen e saj se pranimi i fajësisë korrespondon me provat e ofruara nga prokurori dhe i dënuari, (dispozita e nenit 248 par. 1 pika 1.3 të KPPK - Pranimi i fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar), pra në këtë drejtim aktgjykimi nuk përmban arsye, shkelje kjo e paraparë nga neni 384 par.1 pika 1.12 (Shkelja esenciale e dispozitave të procedurës penale) lidhur me nenin 370 të KPPK-së (Përmbajtja dhe forma e aktgjykimit me shkrim)”.

19. Më 7 mars 2018, Gjykata Themelore në Gjakovë, përmes Aktgjykimit [P. nr. 653/17] e shpall fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme nga neni 332.1 i KPRK-së dhe i shqipton dënim me kusht në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohej nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej 1 (një) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale. Gjithashtu ai detyrohej që në afat prej 1 (një) muaji, të lëshojë banesën e uzurpuar dhe ta kthej në posedim të të dëmtuarës B. M. Gjykata gjithashtu e detyroi të paguajë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh shumën prej 20 (njëzet) euro në emër të paushallit gjyqësor, ndërsa pala e dëmtuar B. M., u udhëzua në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.
20. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës paraqet ankesë për shkak të vendimit lidhur mbi lartësinë e dënimit, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj Aktgjykimin e ankimuar dhe t'i shqiptoj dënim më të butë, apo të anulojë Aktgjykimin dhe lëndën ta kthej në rigjykim.
21. Më 22 maj 2018, Prokurori i Apelit në Prishtinë, me parashtresën [PPA/II. nr. 489/2018], propozoi që ankesa e parashtruesit të kërkesës të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.
22. Më 4 janar 2019, Gjykata e Apelit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata e Apelit) përmes Aktgjykimit [PA1. nr. 482/2018] e refuzon si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe e vërteton Aktgjykimin e Gjykatës Themelore [P. nr. 653/17].
23. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, për shkak të shkeljes së ligjit penal, shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljeve të tjera të dispozitave të procedurës penale të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë Evropiane për të drejtat dhe liritë e njeriut dhe protokollet e saj (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ), me propozim që Gjykata Supreme (i) ta aprovoj si të bazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, të ndryshojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe të dënuarin ta liroj nga akuza ose (ii) t'i anulojë aktgjykimet e kundërshtuara dhe lënda të kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.
24. Më 16 prill 2019, Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit të Kosovës, me shkresën [KMLP. II. nr. 91/2019] propozoi që kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë të refuzohet si e pabazuar.
25. Më 14 maj 2019, Gjykata Supreme, përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 123/2019], refuzon si të pabazuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të paraqitur kundër

Aktgjykimit të Gjykatës Themelore [P. nr. 653/2017] të 7 marsit 2018 dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit [PA1. nr. 482/2018] të 4 janarit 2019.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 123/2019], duke refuzuar si të pabazuar kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] të Kushtetutës.
27. Parashtruesi i kërkesës pretendon se veprës penale uzurpim i paligjshëm i pronës së paluajtshme, i mungon elementi i veprës penale përkatësisht mungesa e uzurpimit arbitrar të cilën e vërteton në bazë të njoftimit të SH. A. "VIRXHINIA" sipas të cilës konfirmohet dhënia në shfrytëzim e banesës me kusht që të njëjtën ta mirëmbajë. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit, në këtë rast i është dhënë përparësi shfrytëzueses B. M. edhe pse e njëjta jeton jashtë Kosovës dhe nuk ka legjitimitet aktiv për shitjen eventuale të banesës. Prandaj parashtruesi është diskriminuar në raport me palën tjetër në procedurë B. M., me ç' rast është shkelur neni 24 i Kushtetutës.
28. Gjithashtu, parashtruesi pretendon se përkundër që Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 109/2017] të 22 gushtit 2017, e ka kthyer rastin në rivendosje me udhëzime në arsyetim që Marrëveshja e Sh. B. me kompaninë "VIRXHINIA" të trajtohet, ky pretendim nuk është shqyrtuar fare në tërë procedurën e përsëritur. Prandaj, parashtruesi konsideron se gjykatat e rregullta e kanë përzier konceptin e banimit dhe konceptin e uzurpimit ngase i dënuari ka vazhduar banimin përgjatë 13 (trembëdhjetë) viteve në mirëbesim. Mbi këtë bazë ai konsideron që janë bërë shkelje esenciale të procedurës penale në tërësi dhe së drejtës materiale gjë që ka rezultuar edhe me shkeljen e Kushtetutës nga neni 31 paragrafi 2.
29. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se Aktgjykimi i kontestuar është marrë në kundërshtim me nenin 30, paragrafi 6 sa i përket shtrëngimit për të dëshmuar kundër vetvetes ose për të pranuar fajësinë e vet. Sipas parashtruesit, ai pretendon se pranimi i veprës është bërë nën frikësimin dhe insistimin ndaj të dënuarit edhe nga ana e mbrojtësit të tij, në kundërshtim me etikën profesionale të avokatit, pra është bërë pranimi i fajësisë gjë që ka rezultuar në shkeljen e nenit 30, paragrafi 6 i Kushtetutës.
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës pretendon se në kuptim të nenit 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta nuk e kanë marrë për bazë Aktvendimin [P. nr. 208/12] të 30 dhjetorit 2014, përmes të cilit është hedhur poshtë padia penale e paditësit subsidiar Bu. M. (tashmë bashkëshorti i ndjerë i palës tjetër në procedurë Bu. M.).

Pranueshmëria e kërkesës

31. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.
32. Në këtë drejtim, Gjykata, fillimisht, i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

33. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47, 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

"1.Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj".

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor ...".

34. Sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar, konteston një akt të një autoriteti publik, gjegjësisht Aktgjykimin [Pml. nr. 123/2019] e 14 majit 2019, të Gjykatës Supreme dhe i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj.

Parashtruesi i kërkesës gjithashtu ka sqaruar të drejtat dhe liritë themelore që ai pretendon se i janë shkelur, në pajtim me kërkesat e nenit 48 të Ligjit, dhe ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatet e përcaktuara në nenin 49 të Ligjit.

35. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara në paragrafin (2) të rregullit 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të të cilave Gjykata mund të shqyrtoj kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jetë qartazi e pabazuar. Rregulli 39 (2), në veçanti përcakton që:

Rregulli 39
[Kriteret e pranueshmërisë]

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

36. Gjykata fillimisht thekson se bazuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës, ajo mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij. Në këtë aspekt, Gjykata rikujton thelbin e çështjes së ngritur nga parashtruesi i kërkesës dhe pretendimet përkatëse.
37. Sa i përket rastit konkret, Gjykata konsideron se pretendimet e parashtruesit të kërkesës mund të reduktohen në: (i) shkelje të nenit 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, (ii) shkelje të nenit 24 të Kushtetutës; dhe (iii) shkelje të nenit 34 të Kushtetutës.

(i) Pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 30 dhe 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së

38. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës shkeljen e pretenduar të nenit 31 të Kushtetutës e arsyeton me qëndrimin se me vendimin e kontestuar nuk janë marrë parasysh udhëzimet e dhëna nga Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Pml. nr. 109/2017] të 22 gushtit 2017, e cila e ka kthyer rastin në rivendosje me udhëzime në arsyetim që Marrëveshja e Sh. B. (babai i ndjerë i parashtruesit) me kompaninë "VIRXHINIA" të trajtohet. Rrjedhimisht, sipas parashtruesit janë bërë shkelje esenciale të procedurës penale në tërësi dhe të drejtës materiale gjë që ka rezultuar edhe me shkeljen e paragrafit 2 të nenit 31 të Kushtetutës.
39. Në këtë drejtim, Gjykata së pari thekson se nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të merret me gabimet e faktit ose të ligjit (ligjshmëria), që pretendohet të jenë bërë nga Gjykata Supreme, Gjykata e Apelit apo Gjykata Themelore, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e parashtruesit të kërkesës të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
40. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është detyrë e saj sipas Kushtetutës, të veprojë si gjykatë e shkallës së katërt lidhur me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë

rregullat përkatëse të së drejtës procedurale, si edhe të asaj materiale (Shih rastin e GJEDNJ-së, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; shih gjithashtu rastin e Gjykatës: KI70/11 të parashtruesve *Faik Hima, Magbule Hima dhe Bestar Hima*, Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011).

41. Është me rëndësi të theksohet se Gjykata mund të shqyrtojë vetëm nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në atë mënyrë që parashtruesi i kërkesës të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, rastin *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, miratuar më 10 korrik 1991).
42. Për më tepër, Gjykata vlerëson se Gjykata Supreme në mënyrë specifike ka adresuar dhe elaboruar pretendimet kryesore të parashtruesit lidhur me shkeljet thelbësore të dispozitave të procedurës penale dhe nëse vendimet e gjykatave më të ulëta ishin të mbështetura në faktet e provuara.
43. Sa i përket pretendimit për shkelje të nenit 31, paragrafi 2 të Kushtetutës lidhur me mosmarrjen parasysh të arsytimit të dhënë nga Gjykata Supreme në Aktgjykimin [Pml. nr. 109/2017] e 22 gushtit 2017, lidhur me trajtimin e Njoftimit të Sh. A. “VIRXHINIA”, Gjykata vëren se kjo çështje është trajtuar nga Gjykata Themelore, ndërsa Gjykata e Apelit nuk e ka pasur objekt vlerësimi gjendjen faktike pasi që e njëjta nuk ka mundur të kontestohet me ankesë për shkak se parashtruesi (i akuzuari) e ka pranuar fajësinë. Prandaj, ndaj Aktgjykimit që merret në bazë të pranimi të fajësisë nuk lejohet ankesë për gjendjen e fakteve.
44. Gjykata vëren se Gjykata Themelore e kishte trajtuar këtë çështje në momentin e vlerësimit të pranimi të fajësisë nga ana e parashtruesit dhe pas vlerësimit të provave ku thekson: “[... gjithashtu tani kemi edhe certifikatën e lëshuar nga njësia kadastrale në Gjakovë, me nr. [0-70705028-05097-3-47-3-8-0] në arsytimin e Aktgjykimit të datës 6 qershor 2018 ku shihet se shfrytëzuese e kësaj banese është B. M...].”
45. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se të gjitha argumentet e parashtruesit të kërkesës, të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, gjykatat e rregullta i kishin shqyrtuar; se arsyet materiale dhe ligjore për vendimin që ai kundërshton janë të paraqitura në mënyrë të detajuar dhe se, në bazë të asaj që u tha më lart, procedurat pranë gjykatave të rregullta, në përgjithësi, ishin të drejta.
46. Në vijim, Gjykata do e trajtojë pretendimin e ngritur nga parashtruesi sa i përket çështjes së pranimi të fajësisë nën frikësimin dhe insistim edhe nga ana e mbrojtësit të tij për ta pranuar fajësinë, ku i janë shkelur të drejtat e tij të përcaktuara me nenin 30, paragrafi 6 të Kushtetutës.
47. Gjykata gjithashtu rikujton se e drejta për një gjykim të drejtë duke përfshirë edhe të drejtat e të akuzuarit, siç garantohet me nenin 30 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, siguron disa garanci minimale për çdo person të akuzuar për një vepër penale, e cila përfshin të drejtën e lirisë nga vetëfajësimi, sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së (Shih Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa nr. 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, të

17 dhjetorit 1996, si dhe *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa 18731/91, paragrafi 45, i 8 shkurtit 1996).

48. Në këtë drejtim, e drejta e personit për të mos fajësuar veten, nënkupton që në procedurën penale kërkohet nga prokurori të provojë çështjen e tij kundër të akuzuarit pa përdorur dëshmi të fituara nëpërmjet metodës së dhunës dhe represionit në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit. E drejta për të mos inkriminuar veten është kryesisht e lidhur me vullnetin e palës së akuzuar për t'u mos deklaruar, përkatësisht të drejtën në heshtje që zbatohet edhe në rastin e marrjes në pyetje të të dyshuarit (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa 19187/91, paragrafët 68 dhe 69, të 17 dhjetorit 1996, si dhe Aktgjykimi i GJEDNJ-së, *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Kërkesa 18731/91, paragrafi 45, të 8 shkurtit 1996).
49. Përfundimisht, e drejta në heshtje nuk është absolute, dhe në vlerësimin nëse procedura ka shkelë vetë thelbin e garancive kundër vetë fajësimit, GJEDNJ-ja i vlerëson në bazë të: a) natyrës dhe shkallës së dhunës, b) ekzistimit të ndonjë mase mbrojtëse relevante, dhe c) përdorimit të provës së fituar në këtë mënyrë. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 8 shkurtit 1996, *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, kërkesa 18731/91, paragrafi 45).
50. Më tej, Gjykata do ta elaboroj pretendimin e parashtruesit të kërkesës se i është shkelur e drejta për mbrojtje dhe garancitë në lidhje me mbrojtjen nga vetë inkriminimi, për shkak se pranimi i fajësisë është bërë nën masa të presionit, frikësimit dhe shtrëngimit për të bërë pranimin e fajësisë.
51. Lidhur me këtë, Gjykata së pari thekson se gjatë vlerësimit nëse procedura ishte e drejtë në tërësi, duhet pasur parasysh nëse janë respektuar të drejtat e mbrojtjes. Në lidhje me këtë, Gjykata do të vlerësojë nëse parashtruesi i kërkesës kishte mundësi ta kontestoj ligjshmërinë e provave dhe të kundërshtoj përdorimin e tyre (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 17 dhjetorit 2013, *Szilagyi kundër Rumanisë*, Kërkesa 30164/04).
52. Përveç kësaj, duhet të merret parasysh edhe cilësia e provës, duke përfshirë nëse rrethanat në të cilat është marrë tregojnë dyshimin për besueshmërinë ose saktësinë e saj (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, *Lisica kundër Kroacisë*, Kërkesa nr. 20100/06, paragrafi 49, e 25 shkurtit 2010; Aktgjykimin e 10 marsit 2009, Kërkesa nr. 4378/02, *Bykov kundër Rusisë*, paragrafi 90).
53. Për më tepër, problemi i drejtësisë nuk do të paraqitet domosdoshmërisht kur dëshmia e marrë nuk mbështetet nga materialet e tjera. Rrjedhimisht duhet pasur parasysh se kur prova është shumë e fortë dhe është e pranueshme pa ndonjë dyshim, nevoja për prova të tjera të cilat e mbështesin atë zvogëlohet (Shih, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 28 qershorit 2009, *Davies kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 18704/05 paragrafi 42, si dhe Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 10 marsit 2009, *Bykov kundër Rusisë*, Kërkesa nr. 4378/02, paragrafi 90).
54. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në rastin e parashtruesit të kërkesës, gjykatat e rregullta kanë konkluduar duke dhënë arsye të mjaftueshme dhe arsyetimet që edhe kjo Gjykatë nuk i konsideron arbitrare, që pranimi i fajësisë është bërë në suaza të garancive procedurale.

55. Gjykata, në këtë drejtim i referohet konkretisht Aktgjykimit [Pml. nr. 123/2019] të 14 majit 2019 të Gjykatës Supreme, e cila, ndër të tjera thekson:

“Është e rëndësishme të theksohet fakti se në rastin konkret i dënuari në prezencë të mbrojtësit të tij ka bërë pranimin e fajësisë gjatë shqyrtimit fillestar dhe atë pas udhëzimeve të dhëna në këtë seancë, ashtu që në faqen e tretë të procesverbalit të shqyrtimit fillestar nga ana e gjyqtarit të gjykatës së shkallës së parë është konstatuar se pranimi i fajësisë nga ana e të dënuarit është bërë me vullnet të lirë, pa presion dhe pas konsultimeve me mbrojtësin e tij avokatin N. D. si dhe pranimi i fajësisë ka mbështetje në provat që gjenden në shkresat e lëndës”.

56. Gjithashtu, Gjykata vëren se Gjykata Supreme në Aktgjykimin e lartpërmendur kishte theksuar që *“Pretendimi se i dënuari nuk kishte kuptuar aspektet e pranimin të fajësisë përkitazi me veprën penale po ashtu nuk ishte i bazuar pasi që të dënuarit duke u bazuar në faqen e dytë të procesverbalit të shqyrtimit fillestar i ishte lexuar aktakuza dhe për më tepër, i dënuari kishte deklaruar se aktakuzën dhe veprën penale e cila i vihej në barrë i kishte kuptuar dhe pastaj ishte deklaruar përkitazi me fajësinë”.*
57. Në bazë të të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konstaton si të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të pretenduara të drejtës për mbrojtje dhe garancitë në lidhje me mbrojtjen kundër vetë inkriminimit.

(ii) Pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 24 të Kushtetutës

58. Parashtruesi i kërkesës pretendon se në këtë rast i është dhënë përparësi shfrytëzueses së banesës B. M., edhe pse e njëjta jeton jashtë Kosovës dhe nuk ka legjitimitet aktiv për shitjen eventuale të banesës. Prandaj, parashtruesi është diskriminuar në raport me palën tjetër në procedurë B. M., me ç'rast është shkelur neni 24 i Kushtetutës.
59. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe nuk ka dëshmuar pretendimin për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 24 të Kushtetutës. Kur pretendohen shkelje të tilla të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të paraqes një pretendim të arsyetuar dhe një argument bindës. (Shih rastin e Gjykatës nr. Kl198/13, parashtrues: *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri, i 13 marsit 2014, rasti Kl136/16, parashtrues: *Ibrahim Svarça*, Aktvendim për papranueshmëri, i 4 nëntorit 2016, paragrafi 43).
60. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton që trajtimi është diskriminues nëse një individ trajtohet ndryshe nga të tjerët në pozita ose situata të ngjashme dhe nëse ky ndryshim në trajtim nuk ka ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm. Gjykata përsërit se trajtimi i ndryshëm duhet të ndjekë një qëllim legjitim për të qenë i justifikuar dhe duhet të ketë një marrëdhënie të arsyeshme proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit që kërkohet të arrihet. (Shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 13 qershorit 1979 *Marckx kundër Belgjikës*, Kërkesa nr. 6833/74, paragrafi 33).

61. Gjkata rikujton, që fakti se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (Shih rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).
62. Në bazë të të gjithave që u thanë më sipër, Gjykata konstaton si të pabazuara pretendimet e parashtruesit të kërkesës për trajtim diskriminues ndaj tij.

(iii) Pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 34 të Kushtetutës

63. Gjykata rikujton që parashtruesi i kërkesës pretendon se në kuptim të nenit 34 [E Drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtën vepër] të Kushtetutës, gjykatat e rregullta nuk e kanë marrë për bazë Aktvendimin [P. nr. 208/12] të 30 dhjetorit 2014, përmes të cilit është hedhur poshtë padia penale e paditësit subsidiar Bu. M. (tashmë bashkëshorti i ndjerë i palës tjetër në procedurë B. M).
64. Gjykata vëren se me Aktvendimin [P. nr. 208/12] e 30 dhjetorit 2014, Gjykata Themelore kishte vendosur hedhjen e padisë penale të paditësit subsidiar Bu. M. dhe pushimin e procedurës penale ndaj të pandehurit Sh. B. (babai i parashtruesit të kërkesës), e jo ndaj parashtruesit të kërkesës.
65. Në këtë drejtim, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka paraqitur ndonjë fakt dhe nuk ka dëshmuar pretendimin për shkelje të të drejtave të tij të garantuara me nenin 34 të Kushtetutës.

Përfundime

66. Në këto rrethana, Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk e ka mbështetur me prova e as nuk e ka arsyetuar mjaftueshëm pretendimin e tij në baza kushtetuese për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutë, specifikisht, për shkelje të nenit 24, 30, 31 dhe 34 të Kushtetutës, sepse faktet e paraqitura nga ai në asnjë mënyrë nuk tregojnë që gjykatat e rregullta i kanë mohuar atij të drejta të garantuara me Kushtetutë.
67. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme siç përcaktohet me nenin 113. 7 të Kushtetutës dhe siç specifikohet më tej me kriteret e pranueshmërisë, përkatësisht rregullit 39 (2) të Rregullores së punës.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 113.7 të Kushtetutës, në nenin 20 të Ligjit dhe rregullat 39 (2) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë Aktvendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë Aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky Aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Radomir Laban



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi